



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3246 Prot.

Tiranë, më , 24.11 2022

VENDIM

Nr. 36 datë 23.11 2022

**“PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE DHE MIRATIMIN E PERIUDHËS SË
VETKANDIDIMIT PËR ANËTARIN E KËSHILLIT TË ETIKËS TË UT-SË,
PËRFAQËSUES I SENATIT AKADEMIK TË UT-SË”**

Bazuar në nenin 44, të Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 43, pika 6, të Statutit të UT-së, në mbledhjen e datës 23.11 2022, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurave të vetëkandidimit për anëtarin e Këshillit të Etikës të UT-së, përfaqësues i Senatit Akademik të UT-së .
2. Periudha e vetkandidimit për anëtarin e Këshillit të Etikës të UT-së, përfaqësues i Senatit Akademik të UT-së, është data 01- 09 dhjetor 2022.
3. Vendimi i përcillet për njoftim të gjithë anëtarëve të Senatit Akademik të UT-së, përfaqësues të personelit akademik të Universitetit të Tiranës.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha

